



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 882 Prot.

Tiranë, më datë 22.06.2023

VENDIM
Nr. 356, datë 22.06.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "*Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj*", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 22.06.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor, hartuar në kuadër të projektit "*Kompleks me Banesa Individuale 2 Dhe 3 Kate, me mur rrethues*", në Pasurinë me Nr. 190/70, Zona Kadastrale 1605, Njësia Administrative Farkë, në pronë të Z. Altin Braushi dhe Znj. Jorida Braushi, me aplikues Klajdo Alibehaj dhe zhvillues **Real Konstruksion**;
2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr.107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar;
3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 145 - 147;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

KRYETAR

Elva MARGARITI

